



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 07.09.2023)*

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 11:15.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                            |                          |
|----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i>  | <i>(kryetare)</i>        |
| <i>2. Ilir Rusi</i>        | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i>  | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>4. Fatmira Luli</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>5. Irena Plaku</i>      | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i>  | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Ridvan Hado</i>      | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>8. Alban Toro</i>       | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>9. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>10. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>11. Yllka Rupa</i>      | <i>(anëtare)</i>         |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

*1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*

**2. Luan Dibra, Këshilltar pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**

**4. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

**5. Edmon Hoxhaj, BIRN.**

## **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2023–2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Mbledhja plenare e datës 07.09.2023 drejtohet nga Kryetarja e Këshillit dhe ka për objekt fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2023 – 2024.

Siç është vepruar gjithmonë, nga Shkolla e Magjistraturës, Këshilli është njoftuar për listën e kandidatëve fitues në provimin e pranimit për ndihmës ligjorë.

Në vijim, është e nevojshme që Këshilli i Lartë Gjyqësor të marrë një vendimmarrje për fillimin e procedurës së verifikimit të këtyre kandidatëve, nëpërmjet hedhjes së shortit, ku do të përcaktohet edhe relatori përkatës.

Zonja Llagami, në cilësinë e Kryetares së Këshillit, ka pengesë në procedurat lidhur me aktet individuale, ndaj shorti do të hidhet midis zonjës Luli dhe zonjës Shehu.

Propozohet që zonja Luli të jetë relatore për 5 nga kandidatët dhe zonja Shehu të jetë relatore për 4 nga kandidatët.

### Procedura e shortit si vijon:

Futen në enën e parë të qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Fatmira Luli, znj. Marçela Shehu.

Futen në enën e dytë të qelqit shiritat e letrës me emrat e kandidatëve: z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet emri i relatores, e cila sipas propozimit do të jetë relatore për katër nga kandidatët: znj. Marçela Shehu.

Përzgjidhen më pas emrat e 4 kandidatëve që zonja Shehu do të jetë relatore: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatores së mbetur në enën e qelqit, e cila sipas propozimit do të jetë relatore për pesë nga kandidatët e mbetur në enën e qelqit: znj. Fatmira Luli.

Përzgjidhen më pas emrat e 5 kandidatëve që zonja Luli do të jetë relatore: z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

E hedhim në votim shortin.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Alban!

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Vetëm Albani.

Alban!

**Alban Toro:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023–2024, për profilin ndihmës ligjor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për z. {...} – relatore znj. Shehu;
  2. Për znj. {...} – relatore znj. Shehu;
  3. Për z. {...} – relatore znj. Fatmira Luli;
  4. Për znj. {...} – relatore znj. Fatmira Luli;
  5. Për z. {...} – relatore znj. Fatmira Luli;
  6. Për znj. {...} – relatore znj. Marçela Shehu;
  7. Për znj. {...} – relatore znj. Fatmira Luli;
  8. Për znj. {...} – relatore znj. Marçela Shehu;
  9. Për z. {...} – relatore znj. Fatmira Luli.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet secilit prej kandidatëve, të përfshirë në pikën 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**